

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.N.SH P. me seli në fshatin K. Komuna e G.,ndaj të të paditurës Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë në Prishtinë,në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarit me shkrim avokatit Rr.K. nga P. i cili e përfaqësoj palën paditëse dhe përfaqësues ligjore Naime Abazi nga Ministria e Drejtësisë përmes autorizimit me shkrim e cila e përfaqësoj palën e paditur),lidhur me pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej;13.883,50 Euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;12.12.2014,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga palët ndërgjyqëse,me datën;05.01.2015 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N.SH P. me seli në fshatin K. Komuna e G..

I.Detyrohet pala e paditur që ti paguaj shumën e përgjithshme prej;10.822,94 euro (dhjetëmijë e tetëqind e njëzetë dy euro e nëntëdhjetë e katër cent),në emër të punimeve të kryera në Parkun Industrial në Drenas (për fazën e pozicionit me numër një dhe me numër dy),prej të cilave për pozicionin numër një shumën prej;4.867,50 euro,ndërsa për pozicionin me numër dy shumën prej;5.955,44 euro,të gjitha këto me kamatë ligjore duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive të borxhit,në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve,nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim,pas pranimit të këtij aktgjykimi.

II.Refuzohet në tërësi si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë për shumën prej;3.060,66 euro.

III.Shpenzimet e procedurës kontestimore,pala e paditur detyrohet ti paguaj palës paditëse në shumën e përgjithshme prej;435,00 euro,në afatin kohor prej 7 (ditëve) pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim

A r s y e t i m

Paditësi N.N.SH P. me seli në fshatin K. Komuna e G. me datën;19.04.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate padinë e saj lidhur me pagesën e borxhit në emër të kryerjes së punimeve shtesë në shumë prej;13.883,50 euro,(prej të cilave;shumën prej;4.867,50 euro në emër të kryerjes së punimeve të pozicionit të parë,shumën prej;5.955,44 euro në emër të kryerjes së punimeve për pozicionin e dytë,ndërsa shumën prej;3.060,66 euro në emër të kryerjes së punimeve për pozicionin e tretë,me kamatë ligjore prej momentit ushtrimit të kësaj padie e deri në pagimin definitive të borxhit të gjitha këto në afat kohor prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim,ndaj palës së paditur Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë në Prishtinë,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e saj si të bazuar,pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Shqyrtimi paraprak i padisë.

Gjykata me rastin e pranimit të kësaj padie dhe në vazhdimësi ka analizuar, vërtetuar dhe ka konstatuar se ka kompetencë lëndore lidhur me shqyrtimin e çështjes juridike të parashtruar si në petitumin e padisë duke iu referuar dispozitave të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës si dhe nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat të Kosovës.

Gjykata paraprakishtë ka njohtuar me aktvendim për përgjigje në padi palën e paditur, e cila në afatin ligjor prej 7 (shtatë) ditëve konkretisht me datën; 28.05.2013 me rastin e dhënjes së përgjigjes në padi ka kundërshtuar pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse, duke pranuar paraprakisht detyrimin e saj sa i përket pozicionit të parë, ndërsa duke kundërshtuar pretendimet e palës paditëse lidhur me pozicionin e dytë me arsyetimin se pala e paditur nuk ka detyrim ndaj palës paditëse për këtë pozicion pasi që nuk ka patur kërkesë për aprovim nga pala, madje as nga vet organi mbikqyrës, ndërsa lidhur me pozicionin e tretë ka kundërshtuar pretendimet e palës paditëse sepse punët e kryera nga ajo kanë qenë korrigjimi i defekteve dhe nuk ka patur punë shtesë, prandaj bazuar në të gjitha i ka propozuar gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për pozicionin e dytë dhe të tretë.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i palës paditëse në seancën përgatitore, në seancat e mbajtura kryesore dhe në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse që konsiston në pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej; 13.883,50 euro, lidhur me kryerjen e punimeve shtesë në ndërtimin e Parkut Industrial në Drenas dhe atë për pozicionin e parë shumën prej; 4.867,50 euro, për pozicionin e dytë shumën prej; 5.955,44 euro dhe për pozicionin e tretë shumën prej; 3.060,66 euro. Sipas të të autorizuarit të palës paditëse përmbushja e detyrimit që rrjedh nga kontrata me nr.MTI-204-010-102-236 e datës; 29.09.2009 është realizuar në tërësi nga pala paditëse sipas instruksioneve të dhëna me gojë nga investitori, madje sipas tij kjo është vërtetuar edhe përmes deklaratave të dhënë pranë kësaj gjykate të zyrtarëve të MTI-së të cilët kanë qenë apo janë duke punuar në këtë ministri. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim.

E autorizuarja e palës së paditur si në përgjigjen në padi, seancën përgatitore, në seancat e mbajtura kryesore e poashtu edhe në fjalën e saj përfundimtare të hartuar me shkrim, ka mbetur pranë pohimit të saj lidhur me pozicionin e parë, ndërsa lidhur me pozicionin e dytë dhe të tretë i ka propozuar gjykatës refuzimin e saj si të pabazuar pasi që edhe nga deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar se operatori ekonomik nuk ka marrë pëlqimin paraprak sa i përket pozicionit të dytë lidhur me punimet të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e dyerve për vendosjen e trafave, kurse për pozicionin e tretë e njëjta ka deklaruar se punimet të cilat i kryer paditësja kanë të bëjnë me korrigjimin e defekteve dhe nuk ka të bëjë me punët shtesë, prandaj krejt në fund i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë sa i përket pozicionit të parë, ndërsa i ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me pozicionin e dytë dhe të tretë. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka cekur.

Baza Juridike.

Objekt shqyrtimi i kësaj çështje juridike ka qenë pagesa e borxhit në shumën e përgjithshme (që rrjedh nga kryerja e punimeve shtesë) në vlerë prej;13.7883,50 euro,si shumë e papaguar nga pala e paditur që rrjedh nga kontrata me evidencë MTI nr; 204-010-102-236 e datës;29.09.2009 për kryerjen e punimeve shtesë në Parkun Industrial në Drenas dhe atë për pozicionin e parë shumën prej;4.867,50 euro,për pozicionin e dytë shumën prej;5.955,44 euro dhe për pozicionin e tretë shumën prej;3.060,66 euro.

Provat e administruara si kontestuese dhe jokontestuese.

Me rastin e administrimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka bërë leximin e tyre duke filluar nga kontrata e nënshkruar nga të dy palët ndërgjyqëse e datës;29.09.2009,dokumentacioni për punët shtesë,drafti final i raportit për pranimin e teknik,dokumentacioni për punët shtesë për grupamtësit për transformatorëve në parkun e biznesit,procesi teknik i datës;09.02.2011,dokumentacioni për punët shtesë për riparimin e shtëpizave të trafave në parkun e biznesit,shkresa e datës;27.10.2009,kërkesa për punët shtesë e datës;05.11.2009,vendimi i lëshuar nga menaxheri i projektit,dokumentacioni për punët shtesë i datës;23.08.2011,përgjigja në padi dhe plotësimi i saj,deklarata e tenderuesit me përmasa dhe llogari,kërkesa urgjente për vazhdimin e punimeve e datës;16.02.2011,kërkesa për pranimin teknik e datës;08.03.2011 dhe procesi teknik i datës;01.03.2011

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së palës paditëse për pozicionin e parë dhe të dytë gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 630 dhe 634 të LMD-së,ndërsa lidhur me refuzimin e pjesës së kërkesëpadsisë së palës paditëse për pozicionin e tretë është bazuar në dispozitat e nenit 633 të LMD-së.

Për pozicionin e parë gjykata ka vendosur aprovimin e kërkesëpadsisë së palës paditëse pasi që e paditura që nga përgjigja në padi e deri në fjalën e tij përfundimtare ka pohuar pretendimin e palës paditëse lidhur me këtë pozicion.

Për pozicionin e dytë gjykata ka vendosur lidhur me aprovimin e kërkesëpadsisë së palës paditëse për faktin se punët e kryera shtesë pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues,paditësja i ka kryer sepse kanë qenë punë urgjente të cilat në mënyrë shprehimore i përcakton neni 634 të LMD-së;*Zbatuesi mund të kryejë punime të paparashikuara edhe pa pengimin paraprak të porositësit, nëse për shkak të urgjencës se tyre nuk ka pasur mundësi të marrë këtë pëlqim.Punime të paparashikuara janë ato ndërmarrja e të cilave ka qenë e domosdoshme për shkak të sigurimit të stabilitetit të objektit,për parandalimin e lindjes së dëmit e që janë shkaktuar nga natyra e papritshme e rëndë e tokës,nga shfaqja e papritshme e ujit, apo nga ndonje ngjarje tjetër e jashtëzakonshme dhe e papritshme.Zbatuesi ka për detyrë që pa vonesë të njoftojë porositësin mbi këto fenomene dhe mbi masat e marra.Zbatuesi ka të drejtë të marrë shpërblim të drejtë për punime të paparashikuara që është dashur të kryhen.Porositësi mund të zgjidhë kontratën nëse për shkak të këtyre punimeve çmimi kontraktues do të duhej të shtohej mjaft për të cilën gjë ka për detyrë që pa shtytje ta njoftojë zbatuesin e punimeve.Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë zbatuesit të punimeve pjesën përkatëse të çmimit për punime të kryera, si dhe një shpërblim të drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.*

Ndërsa lidhur me refuzimin e pjesës së kërkesëpadisë së palës paditëse për pozicionin e tretë në shumë prej;3.060,66 euro,për të cilin pala e paditur pretendon se paditësja ka bërë korrigjimin e defekteve dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me punë shtesë,derisa pala paditësja pretendon se kryer punë shtesë sipas instruksioneve me gojë të marra nga zyrtarët e autoritetit kontraktues,gjykata në këtë rast është bazuar në dispozitën e nenit 633 të LMD-së,në të cilën dispozitë në mënyrë shprehimore thuhet se;për çdo largim nga projekti i ndërtimeve, respektivisht nga punimet e kontraktuara zbatuesi duhet të ketë, pëlqimin shkresor të porositesit.Ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje të shpërblimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shqyrtimin,konstatimin dhe çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së,lidhur me afatin paritiv është bazuar në dispozitën e nenit 509 pika e të LPK-së,ndërsa lidhur me llogaritjen e kamatës ligjore është bazuar në dispozitën e nenit 277 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së,duke i aprovuar propozimin e palës së paditëse për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore nga e pala e paditur në shumën e përgjithshme prej;435,00 euro,dhe atë si në vijim;për hartimin e padisë në shumë prej;90,00 euro,për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej;75,00 euro,si dhe shumë prej 270,00 euro në emër të përfaqësimit për dy seanca të mbajtura (2 x 135,00 euro).

Gjykata pas shtjellimit të kësaj çështje juridike ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 277, nenit 630,nenit 633 dhe nenit 634 të LMD-së,si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
C.nr.186/2013 me datën;05.01.2014

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.